

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 5665 Rep  
Nr. 2079 Kol

Majlinda E. Demollari  
Taksa e Pultes  
20 Paqna



**KONTRATË  
SHIT - BLERJE AKSIONESH**

Sot, më 30/07/2018, përpara meje Majlinda E. Demollari, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Shitësi dhe Blerësi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate Shit-Blerje Aksionesh, me termat e mëposhtme:

**SHITËSI:** *Znj. Valbona Xhafa, shtetase shqiptare, lindur në Thumane, Krujë, më date 02.02.1970, person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me numer 025169852, ketu e më poshtë **SHITESI**;*

**BLERËSI:** *Fondacioni **ALBANIAN BESA CAPITAL** (ketu e më poshtë quajtur ABC), person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 287, datë 19.09.2008 i përfaqësuar në kete kontrate nga Znj. Luljeta Çeno, Drejtoreshë e Departamentit të Finances pranë Fondacionit Albanian Besa Capital, shtetase shqiptare, e lindur në Divjake, Lushnje më datë 13.12.1979, person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e leternjoftimit me nr. 026626002, ketu e më poshtë **BLERESI**;*

**PREMISA PARAPRAKE**

Palet ne kete kontrate kane lidhur me date 23.02.2009 nje kontrate shit-blerje te aksioneve ne nenin 6 te se ciles eshte percaktuar qe vetem Fondacioni ABC ka te drejte te bleje aksionet e mbajtesit (punonjes i Fondi Besa sh.a) ne rastet e pushimit te tij nga puna, te largimit te tij nga puna pa deshiren e punedhenesit dhe te shitjes me deshiren e mbajtesit te aksioneve.

Sa me sipër, Palët bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate shit-blerje aksionesh:

**Neni 1  
Objekti i kontratës**

Shitja e aksioneve të shoqërisë FONDI BESA Sh.a në masën **2,000** (dy mijë) aksione në kapitalin e shoqërisë nga totali prej 5,000 aksione të zotëruara nga aksioneri i shoqërisë Znj. Valbona Xhafa me cilësinë e Shitësit, dhe blerja e tyre nga Fondacioni Albanian Besa Capital me cilësinë e Blerësit në këtë kontratë.

**Neni 2  
Çmimi i shitjes, mënyra e pagesës dhe afati**

Çmimi i shitjes së aksioneve nga Shitësi do të jetë 507.2036 Leke/aksion (peseqind e shtate pike dy mijë e tridhjetë e gjashtë)



Blerësi, Fondacioni Albanian Besa Capital, do të blejë **2,000** (dy mijë) aksione për shumën totale prej **1,014,407.20** (nje milion e katermbedhjetemije e katerqind e shtate e 20/100 Leke). Ne kete shume perfshihet edhe detyrimi tatimor qe ka shitesi sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi i cili do te mbahet dhe derdhet per llogari te tatimeve nga Fondacioni ABC.

Pagesa do të kryhet në llogarinë e shitësit me nr. e llogarise **402050391** pranë Bankës Kombetare Tregtare Tirane.

### **Neni 3** **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i masës prej 0,10% të aksioneve që do të shiten dhe se këto aksione janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor dhe se nuk ka persona të tretë që kanë pretendime në lidhje me këto aksione. Blerësi paguan çdo shpenzim që ka lidhje me këtë kontratë. Blerësi njeh dhe merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë.

### **Neni 4** **Heqja Dorë nga të Drejtat**

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e plotë të tij se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë në cilësinë e pronarit të pjesës së aksioneve që i shiten Blerësit.

### **Neni 5** **Kalimi i Pronësisë**

Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, shitësi Z.Valbona Xhafa humbet pronësinë në masën e 2,000 (dy mijë) aksioneve që zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë FONDI BESA Sh.a, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet e shitura si dhe cilësinë e aksionerit të kësaj të fundit. Ndërsa, Blerësi, Fondacioni Albanian Besa Capital, fiton pronësinë në masën e 2,000 (dy mijë) aksioneve të shitura.

### **Neni 6** **Të Ndryshme**

Blerësi (mbajtës i ardhshëm i aksioneve) në rastin e shitjes së tyre gëzon të gjitha të drejtat sipas ligjit.

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.



**Neni 7**  
**Legjislacioni i Zbatueshëm dhe Juridiksioni**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt gjykimi dhe shqyrtimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata hartohet në 6 (gjashte) kopje në gjuhën shqipe, nga të cilat nga një kopje mbahet nga palët, një kopje depozitohet në Qendren e Regjistrimit të Aksioneve, një kopje depozitohet në Qendren Kombëtare të Biznesit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë FONDI BESA Sh.a dhe një kopje depozitohet pranë zyrës noteriale në të cilën u redaktua.

Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje noterit, ju lexuan palëve kontraktuese, të cilët e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në prezencën time.

**PALËT**

**SHITËSI**

**VALBONA XHAFA**

**BLERËSI**

**Fondacioni Albanian Besa Capital**


Përfaqësuar nga

**LULJETA ÇENO**



**NOTERE**

**Majlinda DEMOLLARI**



NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
MPT: R41606040A  
Tel: 0682861560



ALB

firmë/signature

mbiemri/surname

Çeno

emri/iqeen name

Luljeta

shqetesia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndaj/place of birth

Divjake, Lushnje

datëlindje/date of birth

13-12-1979

data e hetimit/date of issue

17-06-2009

autoriteti/ishuesi/authority

MB

nr. letërnjësimit/card no.

026626002

gjinia/sex

F


data e skadimit/date of expiry

16-06-2019

nr. personal/personal no.

H96213095H





LETËRNJOFTIMI ID  REPUBLIKA E SHQIPËRISE REPUBLIC OF ALBANIA

 **Xhafa Valbona**  
mbiemri/surname  
emri/given name

**Shqiptare/Albanian**  
dite/është/nationality  
vendndaja/place of birth

**Thumane Kr'uje**  
distriktu/district of birth

**02-02-1970**  
data e lëshimit/date of issue

**01-05-2009**  
autoriteti i bashkëpunësuar/authority

**MB**  
firma/signature

 nr. letërnjoftimi/card no.  
**025169852**

**F** gjinia/sex

**30-04-2019** data e skadimit/date of expiry

**H05202060G** nr. personal/personal no.